




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË - KOSOVË, KOSOVO POLJE



Gjimnazi “Hivzi Sulejmani” në Fushë - Kosovë, Adresa: Rruga “Aziz Zhilivoda” Nr.22

Duke u mbështetur në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 02/2016 për Aktivitete jashtëshkollore, kërkesës me numër të protokollit 177/2023 nga SHML Gjimnazi “Hivzi Sulejmani” në Fushë - Kosovë, dhe pëlqimit nga DKA, me 13.04.2023 shpallë:

F T E S Ë P Ë R O F E R T Ë

Ftojme agjencitë turistike të licensuara që të konkurrojnë për organizimin e Ekskursionit katër (4) ditor në Republikën e Shqipërisë për maturanët e Gjimnazit “HIVZI SULEJMANI” në Fushë - Kosovë, viti shkollor 2022/2023.

Në ofertë të parashihet çmimi (oferta duhet të përfshijë vetëm një çmim dhe një hotel), pastaj akomodimin në Hotel i cili përfshinë fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetsore, ushqimin cilësor e kalorik, shërbimin 24 orësh mjekësor, transportin dhe shpenzimet e tjera që paraqiten me rastin e vizitave në pika monumentale dhe vende historike.

Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit (në Durrës) do të jetë tri (3) buajtje në ditën e katërt (4) kthimi për në Fushë - Kosovë.

Agjencionet turistike në oferten e tyre duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Agjencioni të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit,
2. Autobuset të jenë komfor, me klimë dhe WFI,
3. Agjencioni të ketë bërë kontrollimin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike – (Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion me nxënësit maturan),
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës (ekskursionit) dhe dëshmi të shërbimit teknik,
5. Agjencioni duhet të ketë dëshmitë (fotokopje) librezat e autobusave,
6. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferave) të autobusave,
7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje dhe shërbimin mjekësor për të gjithë nxënësit, që nga nisja, kohëzgjatja dhe mbyllja e ekskursionit, pastaj dëshminë e çertifikatës dhe kontratën e punës së mjekut të angazhuar,
8. Rezervimi i hotelit (dëshmi origjinale e vulosur) dhe në bashkëpunim me Hotelin të ofrojë siguri 24 orëshe për nxënësit dhe personelin përcjellës,
9. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit).

Afati i paraqitjes së ofertave me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në Web -faqen zyrtare të Komunës së Fushë - Kosovës. Oferta mbetet e hapur deri me datën 25.04.2023 në ora 12:00.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Dokumentacioni me oferta në emër të shkollës dorëzohet tek zyrtari administrativ (sekretari-ja) e shkollës në - Katin e Parë, në objektin e Gjimnazit "Hivzi Sulejmani" në Fushë-Kosovë.

Pas shqyrtimit të ofertave nga ana e Komisionit në përbërje prej tre anëtarësh (një përfaqësues i autorizuar nga DKA-ja, Kryetari ose një përfaqësues tjetër i Këshillit të Shkollës dhe drejtori i shkollës) do të përzgjidhet oferta me e favorshme e cila plotëson kushtet e kërkuara.

Hapja e ofertave bëhet më datën 25.04.2023 (e martë) në ora 13:00 nga Komisioni kompetent pa praninë e opertatorëve ofertues.

Ofertuesi i përzgjedhur nga komisioni do të njoftohet përmes telefonit apo mjeteve të tjera të komunikimit

Datë: 14.04.2023

Drejtori i shkollës: Msc.Amir Pllana

